

Auditor i Brendshem

Velanis Kosova sha

Shpallje

Kualifikimet:

1. Diplomë Universitare në Banka dhe Financa, Kontabilitet apo në një fushë tjetër të ngjashme;
2. Të paktën tre (3) vjet përvojë pune në bankë ose institucion financiar (Auditim i Brendshëm dhe/ose Auditim i Jashtëm);
3. Kualifikime profesionale në Auditimit të Brendshëm dhe / ose Kontabilitet dhe Auditim (CIA, SHKÇAK, ACCA, etj.);
4. Njohuri dhe përvojë të praktikave, parimeve, procedurave të Auditimit të Brendshëm, si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF);
5. Njohuri të hollësishme të ligjeve dhe rregulloreve të BQK-s;
6. E preferueshme të ketë njohuri mbi ruajtjen e të dhënave dhe proceset e teknologjisë informative.
7. Shkathtësi të shkëlqyera analitike dhe të zgjidhjes së problemeve;
8. Shkathtësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese;
9. Shkathtësi të mira të punës në ekip si dhe në mënyrë të pavarur;
10. Nivel i avancuar i gjuhës angleze dhe përdorimit të paketës së Microsoft Office;

Përgjegjësitë:

1. Planifikon dhe kryen auditime sipas Statutit, Politikës dhe Procedurës së Auditimit të Brendshëm në kompani dhe në pajtueshmëri me Standardet e Auditimit të Brendshëm;
2. Përgjegjës:e për udhëheqjen dhe kryerjen e auditimeve në fushën e Financave, Teknologjisë Informative, Riskut dhe Kreditimit të përcaktuar brenda planit të Auditimit të Brendshëm;
3. Në koordinim me Udhëheqësit e Departamenteve, përgatit propozimet për planin vjetor të Auditimit të Brendshëm;
4. Kryerja e vlerësimit të rrezikut në fushat e auditimit me qëllim të planifikimit vjetor të Auditimit të Brendshëm;
5. Përgjegjës:e për përpilimin e raporteve dhe pajtimin me të audituarit / bartësit e proceseve;
6. Përgjegjës:e për përpilimin e raporteve tjera administrative në baza mujore, tremujore dhe vjetore tek Komiteti i Auditimit dhe Kryeshefit Ekzekutiv;
7. Komunikon në mënyrë efektive rezultatet e auditimit të kryer me personat përgjegjës të njësisë/degës/procesit dhe jep rekomandime rreth veprimeve që duhet ndërmarrë për përmirësim të kontroleve të brendshme;
8. Monitoron implementimin e rekomandimeve të dhëna nga raportet e auditimit;
9. Bën propozime në zbatimin dhe përshtatjen e praktikave të auditimit, përmirësimin e rrjedhës së punës, si dhe përmirësimin e politikave dhe procedurave të brendshme;

10. Ju ofron ndihmë Udheheqësve te Departamenteve në draftimin dhe përditësimin politikave dhe procedurave të operimit.
11. Mbetet kompetent:e në fushën e auditimit dhe sektorin financiar përmes vet iniciativës për zhvillim profesional, informim, dhe ndarjen e njohurive profesionale me anëtarët e tjerë të auditimit;
12. Tregon gatishmëri për ndjekje të trajnimeve për zhvillim profesional; si dhe
13. Detyra të tjera sipas nevojës dhe kërkesave të departamentit dhe Komitetit të Auditimit

Procedura e aplikimit:

Ju lutem dergoni CV-ne dhe nje leter motivimi ne **info@velanis.ch**. Pas seleksionimit të dokumentacionit do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë. Siguria e të dhënave dhe parimet e privatësisë janë të rëndësishme për ne. Ne do t'i trajtojmë të dhënat e juaja me konfidencialitet të plotë.

Afati i aplikimit është deri me datë: 15 Dhjetor, 2021.